



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenin 4 parag. 1.2 dhe nenin 15 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, dhe nenin 15 parag.2.4 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 08 maj 2019, mori,

VENDIM PËR ZËVENDËSIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - KKS

Neni 1

1. Me këtë vendim bëhet zëvendësimi i një anëtari të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, dhe atë:

z. Bekim Bislimi, ish Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë,
zëvendësohet nga,

z. Bekim Zogiani, Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë.

2. Zëvendësimi i anëtarit të cekur, bëhet sipas detyrës zyrtare, konform Udhëzimit Administrativ në fuqi.


Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nr.01-020/04-0038894/18 i datës 11 maj 2018.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr. 01-020/04-0037954/19
Podujevë,
08 maj 2019



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi